

AUTORIZIM
Nr. 2006, datë 4.3.2026

Në mbështetje të ligjit nr. 9967, datë 24.7.2008, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave ‘Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, i ndryshuar; si dhe në zbatim të vendimit nr. 926, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar; të kreut III, të vendimit nr. 832, datë 3.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, të ndryshuar; të vendimit nr. 807, datë 11.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve dhe të kushteve për kalimin e pronës shtetërore në pronë private, në funksion të planeve të përgjithshme vendore”; të vendimit nr. 888, datë 11.11.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, mënyrat dhe procedurat e dhënies në përdorim dhe të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”,

AUTORIZOJ:

1. Znj. Gensila Ilo, drejtor i Drejtorisë së Shitjes së Pronës Publike, në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, të kryej detyrat si vijon:

- a) Të nënshkruajë të gjithë dokumentacionin që lidhet me procedurat e shitjes së pronës shtetërore që privatizohet, e shoqëruar me vulën e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit;
- b) Administrimin e procesit të shitjes së pronës publike dhe marrëdhënieve me të tretët;
- c) Përgatitjen dhe mbylljen e procesit të shitjes së pronës publike, nënshkrimin e kontratave të shitjes, nënshkrimin për legalizimin e kontratave, autorizimin për dorëzimin e pronës, verifikimin e sipërfaqeve të pronës shtetërore që kërkohet të kalojë në pronë private;
- d) Nënshkrimin e korrespondencave me institucionet shtetërore, personat fizikë/juridikë për kërkesat që lidhen me konfirmimin e dokumentacionit dhe dhënien e informacionit për privatizime të kryera ndër vite nga ish-Agjencia Kombëtare e Privatizimit, ish-Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike, ish-Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike dhe Drejtoria e Shitjes së Pronës Publike.

2. Ky autorizim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË DHE INOVACIONIT
Delina Ibrahimaj